



H2H foundation

Adresa: Rruga Dervish Hima,
Pall Leskova, 8/3 , Tiranë

H2H foundation

Address: Dervish Hima Street,
Leskova Building, 8/3, Tirana.



**KKDM
ALBCOLD**

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha

Adresa: Rruga Abdi Toptani, nr. 1, Tiranë

National Committee on Great Dams

Address: Abdi Toptani Street, no. 1, Tirana

**MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI**

MIDIS

**KOMITETIT KOMBËTAR TË
DIGAVE TË MËDHA**

Dhe

H2H FOUNDATION

**COOPERATION
AGREEMENT**

BETWEEN

**NATIONAL LARGE DAM
COMMITTEE**

AND

H2H FOUNDATION

Neni 1
Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë:

1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), me qendër në Tiranë, rruga *Abdi Toptani*, nr. 1, i përfaqësuar nga ing. Arjan Jovani, Kryetar.

1. Fondacioni me emërtimin H2H Foundation, me qendër në rrugën "Dervish Hima", pallati Leskova, shk.2, Ap.54, Tiranë, i përfaqësuar nga znj. Aurela Kalaja, Drejtore Ekzekutive;

Neni 2
Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit midis *Palëve*, si dhe përcaktimin e prioriteteve themelore të këtij bashkëpunimi, mbështetur në legjislacionin në fuqi, në parime dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 3
Parime bazë

Parime themelore rregulluese për bashkëpunimin e *Palëve* janë *autonomia institucionale, interesi dhe respekti i reciprok*.

Neni 4

Drejtimet kryesore të bashkëpunimit të *Palëve* janë:

- a) Vendosja e një bashkëpunimi afatgjatë dhe institucional midis H2H Foundation dhe KKDM.
- b) Shkëmbimi njohurive teknike dhe ekipeve të specializuara dhe të kualifikuara në fushën përkatëse përmes një bashkëpunimi me interes të përbashkët.

Përcaktimi i fushave të studimit me interes të përbashkët në disiplinat e sigurisë së digave, ndërtimit,

Article 1
The parties

The parties to this Agreement are:

1. The National Committee of Large Dams (KKDM), based in Tirana, *Abdi Toptani* street, no. 1, represented by Eng. Arjan Jovani, Chairman.

2. H2H Foundation, based on "Dervish Hima" street, Leskova building, Sc. 2, Ap. 54, Tirana, represented by Mrs. Aurela Kalaja, Executive Director.

Article 2
Purpose

This Agreement aims to regulate the cooperation between *the Parties*, as well as to implement the basic priorities of this cooperation, based on the legislation in force, principles, and common interests.


Article 3
Basic principles

Basic regulatory principles for the cooperation of the Parties are *institutional autonomy, mutual interest, and respect*.

Article 4

The main areas of cooperation between the Parties are:

- a) Establishing a long-term and institutional cooperation between H2H Foundation and ALBCOLD.
- b) Exchange of technical knowledge and specialized and qualified teams in the relevant field through a cooperation of common interest.
- c) Determination of areas of study of common interest in the disciplines of dam safety, construction, design, administration, monitoring and physical removal of dams that have lost their function or economic usefulness.



- c) digave që kanë humbur funksionin apo dobishmërinë ekonomike.
- d) Informimi reciprok mbi të rejat dhe zhvillimet e sektorit të digave të mëdha dhe më gjërë që paraqesin interes për aktivitetin institucional të Palëve.
- e) Shkëmbim të botimeve, rezultateve të punës studimore dhe shkencore, të dokumentacionit teknik informues dhe shkencor, standardeve teknike dhe udhëzuesve teknike të domosdoshëm për projektimin, monitorimin, shfrytëzimin dhe sigurinë e digave të mëdha të vendit, në përputhje me standardet bashkëkohore Europiane e ato të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha (ICOLD);
- f) Organizimi i veprimtarive të përbashkëta shkencore: konferenca, forume, konsultime, seminare etj., për çështje të digave e të lidhura me to; për nderimin, vlerësimin dhe evokimin e meritave të figurave të shquara të inxhinierisë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të digave si dhe bërjen të njohur të rëndësisë shkencore dhe ekonomike të veprave të mëdha ujore të sistemit unik energjetik, bujqësor dhe ujit të pijshëm;
- g) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.
- h) Krijimin e skuadrave dhe bashkëpunimeve intelektuale për të ndikuar në mirëqeverisje për çështje me karakter strategjik, si: aktivizimi i burimeve natyrore përpjesëtimisht me mbrojtjen e ekosistemeve; ndryshimet në hidrologjinë e rajoneve ku janë ndërtuar diga të reja;
- i) Shkëmbime të stafeve dhe eksperteve midis Palëve me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtijshme të stafit nga të dy Palët
- j) Mundësimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta me interes të ndërsjellë. Palët mund të

- k) activities of mutual interest.
- d) Mutual information on news and developments in the sector of large dams and beyond that are of interest to the institutional activity of the Parties.
- e) Exchange of publications, results of research and scientific work, informational and scientific technical documentation, technical standards, and technical guides necessary for the design, monitoring, exploitation, and safety of the country's large dams, *in accordance with contemporary European standards and those approved by the International Commission for Large Dams (ICOLD).*
- f) Organization of joint scientific activities: conferences, forums, consultations, seminars, etc., on dams and related issues; for honoring, evaluating, and evoking the merits of outstanding engineering figures in the field of design and construction of dams, as well as making known the scientific and economic importance of large water works of the unique energy, agriculture and drinking water systems.
- g) Encouraging, supporting, and realizing joint activities of mutual interest.
- h) The creation of intellectual teams and collaborations to influence good governance for matters of a strategic nature, such as: activation of natural resources in proportion to the protection of ecosystems; changes in the hydrology of regions where new dams have been built.
- i) Exchanges of staff and experts between the Parties to develop further training and qualifications of staff from both Parties.

Enabling joint projects and programs of mutual interest. The parties can cooperate based on the legislation in force for fulfilling the conditions of the Water Framework Directive in the field of dams and reservoirs, the creation of an exhaustive inventory for the large dams

bashkëpunojnë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për plotësimin e kushteve të Direktivës Kuadër të Ujit në fushën e digave dhe të rezervuarëve, krijimin e një inventari shterues për digat e mëdha të Shqipërisë që janë jashtë funksionit dhe për kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta për të ardhmen e tyre duke patur në fokus sigurinë e njerëzve në zonat poshtë digave, përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në zonat ku do të shtrihen projektet.

Neni 5 **Detyrime e palëve**

- a) H2H FOUNDATION mirëpret pjesëmarrjen e anëtarëve të propozuar nga KKDM në konsultimet me institucionet dhe publikun, në seminare si dhe në inspektime të ndryshme në terren në varësi të projekteve që do të bashkëpunojnë.
- b) Me kërkesë të KKDM, H2H Foundation jep kontribut, sipas mundësive të tij, edhe për një bashkëpunim dhe pjesëmarrje të frytshëm me Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD).
- c) KKDM mirëpret organizimin e bashkëpunimit me grupet e ekspertëve dhe konsulentëve të kualifikuar dhe të specializuar që janë pranë H2H Foundation në fushën e inxhinierisë, të mjedisit, Monitorimit dhe Sigurisë së digave dhe me kërkesën e tyre merr pjesë në veprimtaritë përkatëse.
- d) H2H Foundation merr përsipër të ofrojë realizimin e fushatave sensibilizuese për projekte me interes të përbashkët.

Neni 6 **Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit**

- e) Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit shkencor që ruhet në arkivat e tyre; të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe raporteve.

of Albania that have lost their function and for conducting analyzes and joint studies for their future, focusing on the safety of people in the areas below the dams, the improvement and protection of the environment, as well as the improvement of the quality of life of the residents in the areas where the projects will be extended.

Article 5 **Obligations of the parties**

- a) H2H FOUNDATION welcomes the participation of members proposed by ALBCOLD in consultations with institutions and the public, in seminars as well as in various field inspections depending on the projects they will cooperate with.
- b) At the request of ALBCOLD, H2H Foundation contributes, according to its possibilities, also for a fruitful cooperation and participation with the International Commission of Large Dams (ICOLD).
- c) ALBCOLD welcomes the organization of cooperation with the groups of qualified and specialized experts and consultants who are with the H2H Foundation in the field of engineering, environment, monitoring and safety of dams and at their request participates in the relevant activities.
- d) H2H Foundation undertakes to provide awareness campaigns for projects of common interest.

Article 6 **Exchange of publications and information**

- e) The parties ensure mutual exchange of scientific information stored in their archives; of periodical studies and reports that are published.

Article 7



Neni 7

Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve* kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme.

Neni 9

Njoftimet dhe komunikimi ndërmjet palëve

Palët angazhohen të mbajnë linja të hapura komunikimi në të gjitha nivelet dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për punën e tyre.

Çdo njoftim dhe komunikim mes *Palëve* për këtë Marrëveshje duhet të jetë në formë të shkruar.

Komunikimet për efekt të kësaj marrëveshjeje do të kryhen drejtpërdrejt me përfaqësues të caktuar të H2H Foundation si dhe të KKDM.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje është çështje *dypalëshe*. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime. Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë njëvjeçare për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Ky memorandum ka fuqi veprimi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rinovimi, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja vjen për shkaqe juridike të paparapara dhe kur:

With the will of the *Parties*, cooperation protocols are attached to this Agreement with deadlines to be

With the will of the *Parties*, cooperation protocols are attached to this Agreement with deadlines to be determined by discussion between them. Protocols can be signed for a single activity.

Article 9

Notices and Communication between the Parties

The parties undertake to maintain open lines of communication at all levels and to exchange any information necessary for their work.

Any notification and communication between the Parties regarding this Agreement must be in writing.

Communications for the effect of this agreement will be carried out directly with designated representatives of the H2H Foundation and from ALBCOLD.

Article 10

Dispute resolution

This Agreement is a *bilateral issue*. For ambiguities and possible complaints, the *Parties* do not request an appeal to any other instance. Disputes between the *Parties* are resolved through negotiations. In case of failure to reach an agreement for a period of one year on disputed issues, this Agreement loses its force.

Article 11

Effectiveness and Duration

This Agreement is effective from the date of signature.

Ndryshon statuti ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;

Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cënimin e interesave bazë të saj për shkak rrjedhojave të paparashikuar në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj marrëveshje;

Njëra nga palët bën një deklaratë publike për mungesë vullneti në vijimin e kësaj marrëveshje .

Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën Palë, me vlerë të barabartë.

This memorandum is effective for a period of 5 (five) years with the right of renewal, except in cases where it is terminated for unforeseen legal reasons and when;

The legal statute of the institution changes, and this change affects their basic functions, with an effect on the other Party.

One of the Parties expresses in writing and in a reasoned manner the concern about the violation of its basic interests due to unforeseen consequences in the process of fulfilling the terms of this agreement.

One of the parties makes a public statement about the lack of will in following this agreement.

The agreement is signed in two copies, both in the Albanian language, one for each Party, with equal value.

Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha/National Committee of Large Dams

H2H Foundation

Kryetar/ Chairman

Drejtör Ekzekutiv/ Executive Director

Ing. Arjan JOVANI



Aurela KALAJA

